

PROGRAMET ME KARTË
TË PARAPAGUAR



ALBtelecom

MIRË SE VINI NË RRJETIN MOBILE TË ALBTELECOM!

Zgjidhni shërbimin me kartë të parapaguar të rrjetit **ALBtelecom Mobile** dhe zbuloni komunikimin e vërtetë, me tarifatat më të favorshme dhe ofertat më të mira në treg.

Tashmë, ju do të jeni pjesë e atij komuniteti të madh që ka zgjedhur ALBtelecom e që komunikon më mirë, më lirë dhe duke përdorur shërbimet më bashkëkohore. Duke ju falënderuar që zgjodhët ALBtelecom, ju sigurojmë se do të jemi gjithmonë pranë jush për plotësimin e kërkesave tuaja dhe për ofrimin e shërbimeve të reja e cilësore.

Çfarë përmban paketa e shërbimit të parapaguar?

- Kartë **USIM**,
- Kod **PIN** dhe **PUK**,
- **Broshurë** me udhëzimet për përdorimin e shërbimit

Kur blini një kartë të parapaguar të rrjetit ALBtelecom Mobile, ju duhet të plotësoni formularin e regjistrimit me të dhënat e nevojshme personale. Regjistrimi i numrit është detyrim ligjor dhe kusht për të aktivizuar numrin. Formulari i regjistrimit, së bashku me dokumentet shoqëruese të plotësuara nga ju në dyqanet ALBtelecom dhe/ose në pikat e autorizuara të shitjes, përbëjnë informacion konfidencial, me përjashtim kur ligji parashikon ndryshe.

KARTA USIM

Si ta përdorni kartën USIM?

Karta juaj vjen në tre formate: Nano, Micro, Standarde (të cilën e zgjidhni në varësi të pajisjes që përdorni). Fillimisht duhet të vendosni kartën USIM në aparatin tuaj celular. Karta **USIM** vendoset në folenë që zakonisht ndodhet në pjesën poshtë baterisë në aparat. Por ka pajisje tek të cilat karta **USIM** mund të vendoset në folenë që gjendet në anë, apo si pjesë e pajisjes (konsultohuni me manualët e pajisjeve). Pasi të keni vendosur kartën **USIM** në aparatin tuaj, në ekran do të shfaqet mesazhi për formimin e kodit PIN. Pasi të keni formuar kodin tuaj **PIN 1** që gjendet në pjesën e pasme të kartelës mbajtëse të kartës USIM dhe të kryeni konfirmimin, në ekranin tuaj do të shfaqet një mesazh mirëseardhjeje në rrjetin **ALBtelecom**. Tani ju mund të provoni e të përfitoni shërbimet e cilësisë së lartë dhe bashkëkohore të ofruara nga **ALBtelecom**.

KUJDES! Karta USIM është shumë e ndjeshme. Ajo nuk duhet të ekspozohet në diell dhe në temperatura të larta. Gjithashtu, tregoni kujdes ndaj pjesës metalike të saj. Gërvishtjet sado të vogla e bëjnë atë të pavlefshme. Ruani në një vend të sigurt kodet tuaja PIN dhe PUK pasi këto janë kodet tuaja të identifikimit.

Avantazhet e kartës USIM

Karta juaj **USIM** ju ofron mundësinë të ruani në memorien e saj deri në 200 kontakte dhe **10 SMS**. Karta USIM ka të përfshirë ALBtelecom Menu, e cila është dinamike dhe nëpërmjet së cilës mund të kryeni veprime si:

- Të informoheni mbi gjendjen e llogarisë suaj;
- Të rimbushni llogarinë tuaj;
- Të merrni në telefon Sistemin Automatik të Përgjigjes (**141**);
- Të lidheni me Shërbimin e Kujdesit ndaj Klientit;
- Të përdorni direkt menunë ALBtelecom Star (***100#**);
- Të telefononi numrat e emergjencës;
- Të kërkonit aktivizim ALBwifi;
- Të regjistroheshi në aplikacionin "Profili Im".

Kodet PIN/PUK

Për të gjetur kodet e kartës suaj, duhet të gërvishtni sipërfaqen përbri secilit kod.

Ju si klient keni marrë së bashku me kartën USIM edhe kodin PIN 1. Kodi **PIN 1** (Numri Personal i Identifikimit) është një kod prej **4 shifrash**, i cili shërben për t'ju dhënë vetëm juve të drejtën e përdorimit në celularin tuaj dhe njëkohësisht për të mos lejuar përdorimin e tij nga persona të paautorizuar. Ky kod duhet të ruhet si informacion konfidencial. Çdo klienti i lejohet **ta ndryshojë e ta personalizojë** kodin e tij **PIN 1**. Në qoftë se e vendosni tri herë gabim kodin **PIN 1**, atëherë karta juaj do të bllokohet dhe mund të zhblokohet vetëm me anë të kodit **PUK 1**.

Kodi **PIN 2** është një tjetër kod prej **4 shifrash**, i cili shërben për të hyrë në disa funksione të caktuara të kartës. Në qoftë se për të hyrë në një funksion nevojitet kodi **PIN 2**, në ekranin e celularit tuaj do të shfaqet automatikisht një mesazh që kërkon vendosjen e këtij kodi.

Kodi **PUK** (Çelësi Personal i Zhbllokimit) shërben për të zhbllokuar kartën tuaj në rast se vendosni tri herë gabim kodin **PIN**. Kodi **PUK 1** shërben për të ndryshuar kodin e bllokuar **PIN 1**, ndërsa kodi **PUK 2** shërben për të ndryshuar kodin e bllokuar **PIN 2**. Në rastin kur nevojitet të vendosni njërin nga kodet **PUK**, një mesazh do të shfaqet automatikisht në ekranin e celularit tuaj.

SHËRBIMET BAZË

Shërbimi i telefonatave

Për të kryer një telefonatë nga celulari juaj veproni si më poshtë:

- Në drejtim të një numri telefoni fiks:
Prefiksi i qytetit → Numri i telefonit → ok.
Për shembull, thirrje drejt Tiranës: 042200123
- Në drejtim të një pajtimtari të një rrjeti të telefonisë celulare në Shqipëri:
Prefiksi i rrjetit 067/066/068/069 → Numri i celularit → ok.
- Në drejtim të një rrjeti fiks ose celular jashtë Shqipërisë:
Prefiksi Ndërkombëtar → Prefiksi i rrjetit → Numri i Telefonit → ok.

Shërbimi SMS

Shërbimi i mesazheve të shkurtra (SMS) mundëson dërgimin dhe marrjen e mesazheve të cilat përbëhen nga maksimumi 160 gërma (karakterë). Numri i qendrës së mesazheve ALBtelecom është +355672098000.

Shërbimi MMS

Ky shërbim u jep mundësinë të gjithë pajtimtarëve të rrjetit ALBtelecom të zgjerojnë përdorimin e mesazheve të tyre me foto, muzikë dhe video. Konfigurimi kryhet me tekst **MMS** në **54000**.

Shërbimi ALBtv mobile

Regjistrohuni në paketën ALBtv Mobile dhe shikoni kanalet tuaja të preferuara televizive nga telefoni juaj smart!

Si të informohem për kreditin e mbetur?

Ju mund të njoftoheni për sasinë e parave që gjenden në llogarinë tuaj sa herë të dëshironi, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Shkarkoni aplikacionin "Profili Im" dhe ndiqni hapat përkatës të regjistrimit;
- Telefononi në numrin **141** dhe ndiqni hapat përkatës;
- Dërgoni një **SMS** me tekst "**Balance**" në numrin **141**;
- Formoni ***123#** në celularin tuaj dhe shtypni butonin e thirrjes;
- Nëpërmjet **ALBtelecom Star *100#**, në kategorinë "**Shërbime Bazë/ Kontrolli i Balancës**";
- Nëpërmjet **ALBtelecom Menu/Me Parapagesë/Shërbime Bazë/Balanca**.

Shërbimi i informacionit mbi kreditin e mbetur është pa pagesë, pavarësisht mënyrës që zgjidhni për ta marrë këtë informacion.

SHËRBIMET E INTERNETIT

Interneti në celular

Ju mund të lidheni me **internetin e shpejtë** dhe të përdorni faqet dhe aplikacionet tuaja të preferuara me shpejtësinë më të lartë dhe çmimin më të lirë në treg. Interneti ALBtelecom ju mundëson shpejtësi të lartë, siguri, cilësi kudo ku jeni, edhe në lëvizje. Në zonat me mbulim 4G, keni mundësi për shpejtësi shkarkimi (download) deri 300 Mbps, si edhe shpejtësi ngarkimi (upload) deri në 75 Mbps.

ALBwifi

Abonentët ALBtelecom në rrjetin mobile kanë mundësi të përfitojnë internet Wi-Fi në shërbimin **ALBwifi**. Ky internet përdoret në laptop, tablet apo smartphone. Për të përdorur shërbimin vizitoni ALBtelecom Menu (*100#), ose dërgoni SMS nga numri juaj ALBtelecom me tekstin WIFI në 55544.

SSID "ALBtelecom" mund të aksesohet duke marrë një kod ditor i cili do të vendoset në portalin që do hapet pasi të jeni lidhur me SSID dhe mund të përdoret në laptop, tablet apo smartphone, me mundësi aksesimi deri në 3 pajisje njëkohësisht. Për të përdorur shërbimin, vizitoni ALBtelecom Menu (*100#), ose dërgoni SMS nga numri juaj ALBtelecom me tekstin WIFI në 55544.

SSID "ALBwifi" mund të aksesohet nga të gjithë abonentët ALBtelecom Mobile, duke mundësuar autentifikimin në rrjetin WIFI me anë të kartës USIM. Për ta realizuar këtë, duhet shkarkuar programi ALBwifi i cili do të bëjë konfigurimin automatik të telefonit tuaj Android. Për telefonat me sistem iOS, kërkoni konfigurimet tek numri 54000, ku bashkë me rregullimet e shërbimit internet do të shkarkoni edhe profilin për ALBwifi. Manualisht mund të bëhet duke zgjedhur EAP-SIM ose SIM në telefonin tuaj, si mënyre autentifikimi.

SHËRBIMET NDIHMËSE

Menuja 141

Nëse telefononi në numrin 141 (Menuja 141) dhe ndiqni hapat përkatës, do të mund të informoheni për gjendjen e llogarisë; do të mund të rimbushni llogarinë tuaj; do të transferoni kredit nga llogaria juaj.

ALBtelecom STAR

"ALBtelecom Star" mbledh të gjitha shërbimet në një menu të vetme. Të gjithë pajtimtarët e rrjetit celular ALBtelecom mund të hyjnë në këtë menu duke formuar ***100#** dhe duke shtypur butonin e thirrjes.

Profili im

Menuja/aplikacioni "**Profili im**" ju mundëson kontroll online të numrit tuaj. Nëpërmjet saj mund të informoheni mbi abonimin tuaj, balancën, ofertat e aktivizuara dhe konsumin e tyre. Gjithashtu mund të rimbushni llogarinë apo të përzgjidhni shërbimet që dëshironi. Për versionin nga faqja online vizitoni "**Profili Im**" në faqen tonë, ose direkt në <http://profiliim.albtelecom.al/>

Në qoftë se nuk e mbani mend numrin tuaj

Në qoftë se nuk e mbani mend numrin tuaj, mund ta mësoni atë fare thjesht, duke shtypur ***888#** dhe më pas butonin thirrje. Ky kod është i vlefshëm për shumicën e aparateve celulare.

Shërbimi i identifikimit të thirrjeve të humbura


Shërbimi i identifikimit të thirrjeve të humbura u jep mundësinë pajtimtarëve të rrjetit **ALBtelecom Mobile** të njoftohen në lidhje me thirrjet e humbura nga pajtimtarë të tjerë kur telefoni i tyre ka qenë i fikur apo jashtë zonës së mbulimit. Ky shërbim identifikon momentin kur pajtimtari është i disponueshëm dhe e njofton atë me anë të një mesazhi **SMS** në lidhje me numrin, orën dhe datën e këtyre telefonatave. Për ta aktivizuar këtë shërbim, formoni ****62*0672004321#** dhe shtypni butonin e thirrjes. Në momentin që aktivizohet shërbimi i identifikimit të thirrjeve të humbura, shërbimi i sekretarisë telefonike çaktivizohet automatikisht. Ky shërbim është pa pagesë.

Sekretaria telefonike

Sekretaria telefonike vlen kur ju të keni fikur telefonin. Kushdo që telefonon mund të regjistrojë një mesazh zanor, të cilin do ta dëgjojë kur të ndezë telefonin. Sekretaria telefonike është e aktivizuar automatikisht për të gjithë pajtimtarët ALBtelecom të rrjetit Mobile kur pajtimtari nuk është i arritshëm, por nëse doni ta aktivizoni edhe në rastet e tjera, mund të vendosni nga telefoni juaj numrin 0672004322 që ju transferon tek ky shërbim, ose të formoni direkt kodin **62*0672004322# dhe të shtypni butonin e thirrjes.

Kujdesi ndaj Klientit 123

Për çdo paqartësi, pyetje apo informacion, ju mund të telefononi në numrin 123. Një operator do t'ju asistojë për çdo shqetësim apo problem që mund të keni. Sistemi automatik i përgjigjes (IVR) dhe stafi ynë profesional i Shërbimit të Klientit është i gatshëm në çdo kohë, duke e bërë jetën tuaj më të lehtë me shërbimet e cilësisë së lartë që ofron ALBtelecom, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Ju gjithashtu mund të telefononi Shërbimin e Klientit nga cilido numër fiks apo celular, në numrin: 067 123,+355 67 123 apo 042200123.



RIMBUSHJE

Ju mund ta rimbushni llogarinë tuaj sa herë të dëshironi duke përdorur një nga mënyrat e mëposhtme:

Rimbushje Elektronike

Kryhet në të gjitha dyqanet e ALBtelecom ose në pikat e autorizuara të shitjes, nëpërmjet sistemit elektronik të rimbushjes. Rimbushja elektronike ju mundëson që të rimbushni shumën të ndryshme dhe kreditin ta përdorni për ofertat dhe shërbimet e ALBtelecom në rrjetin celular. Përfaqësuesi i shitjeve ju pajis me një faturë që vërteton kryerjen e rimbushjes nga ana juaj.

Kartat Rimbushëse

Përdoren për të shtuar kreditin në llogarinë tuaj nëpërmjet kodit të kartës rimbushëse. Telefononi në numrin **141** dhe ndiqni udhëzimet përkatëse ose dërgoni në numrin **141** një SMS me tekst RM (hapësirë) dhe kodin e kartës rimbushëse me **12 shifra**, p.sh **RM 123456789012**. Gjithashtu, ju mund ta rimbushni kartën tuaj nëpërmjet **ALBtelecom Star *100#**, ose ALBtelecom Menu, nën kategorinë "Shërbime Bazë". Kartat rimbushëse ALBtelecom mund t'i gjeni në të gjitha dyqanet e kompanisë, në pikat e autorizuara, si edhe kudo që do të shikoni shenjat dalluese të kompanisë ALBtelecom .

Rimbushje nëpërmjet bankomatit:

Kryhet shumë thjesht nga menuja e bankomateve të BKT, kudo që këto bankomate gjenden. Nëpërmjet këtij shërbimi do të keni mundësi ta rimbushni shumë thjesht me shuma të caktuara numrin tuaj me parapagesë.

ALBstore

Ky shërbim mundëson rimbushjen e numrit tuaj nëpërmjet portalit që gjendet në faqen tonë të internetit albstore.albtelecom.al

Si të rimbushni llogarinë e një personi tjetër?

Shërbimi "Rimbushja e një numri tjetër ALBtelecom" ofrohet nëpërmjet menuse ALBtelecom Star *100# nën Shërbime Bazë ose nëpërmjet aplikacionit "Profili Im" dhe mundëson rimbushjen e llogarisë së një pajtimtari tjetër me parapagesë të rrjetit celular, ALBtelecom.

Transferimi i kreditit

Ky shërbim mundëson transferimin e kreditit nga një numër me parapagesë, tek një numër tjetër me parapagesë dhe ofrohet nëpërmjet menuse ALBtelecom Star (*100#) ose aplikacionit "Profili Im". Veprimi i transfertës tarifohet sipas tarifave në fuqi.

SHËRBIME TË TJERA

ROAMING

Shërbimi Roaming është shërbimi që u mundëson pajtimtarëve të rrjetit mobile **ALBtelecom** përdorimin e telefonatave (dalëse dhe hyrëse), shërbimeve të mesazheve, të transmetimit të të dhënave apo shërbimeve të tjera, kur ata gjenden **jashtë territorit të Shqipërisë**.

Kur jeni duke përdorur shërbimin **Roaming** dhe dëshironi t'i telefononi dikujt në **Shqipëri** apo t'i dërgoni një mesazh, mos harroni të vendosni prefiksin e **Shqipërisë (+355)** përpara numrit të thirrur, pasi numrat e ruajtur në celularin tuaj në formatin 0672345678 do të jenë të paarritshëm nëse nuk vini prefiksin e Shqipërisë. Prefiksin e shtetit duhet ta vendosni edhe nëse kryeni thirrje të tjera.

Shërbimi 4G ofrohet në rrjetet ku ka marrëveshje përkatëse.

CLIP

Shërbimi CLIP është funksioni që bën të mundur shfaqjen e numrit tuaj në ekranin e pajtimtarit të cilit i drejtohet telefonata. Ky shërbim është i aktivizuar automatikisht dhe ofrohet pa pagesë për të gjithë numrat e rrjetit **ALBtelecom Mobile**.

CLIR

Shërbimi CLIR është funksioni që mundëson fshehjen e numrit tuaj në ekranin e pajtimtarit të cilit i drejtohet telefonata. Pajtimtari mund ta aktivizojë këtë shërbim nga menuja e aparatit të tij ose duke formuar kodin #31# përpara numrit të thirrur. Ky shërbim është pa pagesë. Numri nuk do të fshihet nëse ju dërgoni SMS me numër të fshehur.

Numrat e Emergjencës

Për çdo rast ose për çdo problem, ju mund të telefononi falas nga telefoni juaj në numrat e mëposhtëm:

- Numri i Harmonizuar Europian i Emergjencës **(112)**,
- Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët **(116)**,
- Emergjencia Detare **(125)**,
- Policia Rrugore **(126)**,
- Urgjenca Mjekësore **(127)**,
- Shërbimi Zjarrfikës **(128)**,
- Shërbimi i Policisë **(129)**.

Shënime

ALBtelecom do të shqyrtojë kërkesat dhe ankesat e pajtimtarëve për t'u dhënë zgjidhjen e duhur, si edhe do të lajmërojë pajtimtarët në lidhje me ndryshimet e tarifave në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Tarifat favorizuese ose të ulëta mund të hyjnë në fuqi menjëherë.

Pajtimtari detyrohet të mos përdorë ose të mos lejojë persona të tretë të përdorin shërbimet e dhëna/Kartën USIM për ri-rrugëzim të thirrjeve apo komunikimeve telefonike të gjeneruara nga palë të treta duke përdorur rrjetin ALBtelecom Mobile, ose në rast se ato bien në kundërshtim me ligjin, moralin dhe rregullat e etikës, ose për të fyer, dëmtuar, shqetësuar, ngacmuar dhe/ose irrituar një pajtimtar tjetër. Në rast të tillë, pajtimtari duhet të mbajë përgjegjësi dhe do të përgjigjet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

ALBtelecom rezervon të drejtën e rishikimit dhe ndryshimit të përmbajtjes së këtij dokumenti sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Për të marrë informacion për pikat e shitjes, produktet dhe shërbimet tona, apo për çdo informacion të nevojshëm, ju lutem vizitoni faqen zyrtare www.albtelecom.al

TIRANA

•21 Dhjetori, Sheshi Ataturk • Sheshi Willson, Rruga "Miqësia", Pallati Sigma • Rr. e Elbasanit • Rr. "Myslym Shyri", Nr. 42 • Blv. Zogu i Parë • Kamëz, Blv. Blu, Qendra e Biznesit, Kati 1 • Komuna e Parisit • Rruga "Çamëria" (dyqani në qendër) • Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit • Aeroporti "Nënë Tereza", Rinas • Rruga e Durrësit, • Rruga e Dibrës, pranë Selvisë • Don Bosko • Njësia Bashkiake Nr. 1; Rr. "Ali Demi", Pallati Nr. 135 Sh7/1 • Njësia Bashkiake Nr. 9, Blv. Zogu i Parë, Pall. Nr. 1 ; Kati 1, pranë stacionit të trenit • Njësia Bashkiake Nr. 5; Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 31, Shk. 1, Ap.1/Kati 1 • Njësia Bashkiake Nr. 11; Rr. "Lord Bajron", Pall. 54/1, Shk. 1 Ap. 1/1, Laprakë • Sheshi Vora; Rruga "Demokracia", Nr. 13; Qendra Tregëtare; Vorë • Rr. "Llambi Bonata", Pallati 41, Kati 1, Ap. 7, Kombinat • Njësia Bashkiake Nr. 3; Rr. "Hoxha Tasim"; Pall. Nr. 261/2 Kati 1

BALLSH

• Lgj. 5 Shkurti, Rr. "Rrapo Hekali"

BILISHT

• Lgj. 2, Rr. "Kosova"

BERAT

Lgj. 10 Korriku, Rr. "Antipatrea"

BULQIZË

• Lgj. "Minatori"

BURREL

- Sheshi Ahmet Zogu

COROVODË

- Lgj. "Çlirimi", "Rruga e Dëshmorëve"

DURRËS

- Lgj. 3, Rr. "Tregëtare"
- Lgj. 11, Rr. "Ismail Qemali"
- Qendër, Shkozet 4
- Lgj. 4, Rruga "Egnatia"
Zona kadastrale 8514, Nr. pasurie 2/31,

ELBASAN

- Lgj. "28 Nëntori", Rr. "Lublin Dilja"

FIER

- Lgj. "Liri", Rr. "Jakova Xoxa"
- Lgj. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"

FUSHË KRUJË

- Qendër

GRAMSH

- Lgj. "Holta", P. 46

HIMARË

- Qendër

KËLCYRË

- Lgj. 1, Rruga "Musa Fratari"

CËRRIK

- Lagjia 2

DELVINË

- Rr. "Sinan Ballaci"

ERSEKË

- Rr. "F.S. Noli", Blloku Nr. 5

GJIROKASTËR

- Lgj. 18 Shtatori
- Lgj. "Varosh", Rr. "Doktor Vasil Laboviti", Nr. 3

HAS

- Qendër

KAVAJË

- Lagjia 3

KONISPOL

- Sheshi "Alush Taka", Rr. "Dëshmorët"

KOPLIK

- Lgj. "Mehaj"

KRUJË

- Qendër, pranë Bashkisë

KUÇOVË

- Blloku "Tafil Skëndo"

LAÇ

- Lagjia 3

LIBOHOVË

- Sheshi "Avni Rustemi"

LUSHNJË

- Lgj. "Kongresi"

MAMURRAS

- Rr. "Zef Hoti"

MIRDITË

- Rr. "At Gjergj Fishta"

PEQIN

- Lgj. "Xhami"

KORÇË

- Blv. "Republika"
- Bulevardi "Gjergj Kastrioti"
Pallati Nr 2, tek Optika

KSAMIL

- Sheshi "Miqësia"

KUKËS

- Lgj. 5, Rr. "Dituria"

LEZHË

- Lgj. "Varosh", Rr. "Gjergj Fishta"

LIBRAZHD

- Lagjia 1, P. 37

MALIQ

- Rr. "Bulevard Rinia"

MEMALIAJ

- Lgj. 4, Rr. "Tafil Buzi", Nr.7

PATOS

- Lgj. "1 Maj", Rr. "Sulo Goxhaj"

PËRMET

- Lgj. "Partizani", Rr. "Mentor Xhemali"

PESHKOPI

- Blv. "Elez Isufi"

PRRENJAS

- Lagjia 1, P. 28/1

ROSKOVEC

- Lgj. 1, Rruga kryesore

SARANDË

- Rr. e Flamurit

SHIJAK

- Lgj. Popullore

TEPELENË

- Lgj. "Selam Musa", Pallati Nr. 3; Kati 1

URA VAJGURORE

- Lgj. "18 Tetori", Rr. "4 Dëshmorët"

PLAZH

- Lgj. 13, Hekurudha

POGRADEC

- Rr. "Rinia", Lagjia 2

PUKË

- Lgj. Qytet, Rr. "Dëshmorëve"

RROGOZHINË

- Lagjia Nr.1

SHËNGJIN

- Rr. "Nënë Tereza"

SHKODËR

- Lgj. "Vasil Shanto", Blv. "Skanderbeg"
- Lgj. "Parrucë", Blv "Zogu i Parë"

TROPOJË

- Lgj. "28 Gushti", Rr. "Sulejman Vokshi"

VLORË

- Lgj. "Pavarsia", Rr. "Sadik Zotaj", Kulla "Hanxhari 1"
- Lgj. "28 Nentori", Rr. "Mulla Xhaferri"



Individë 123 | Biznese 149



www.albtelecom.al